



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI
Byroja

V E N D I M

Nr. 86, datë 06.07.2021

**PËR DISA NDRYSHIME NË RREGULLOREN PËR AKREDITIMIN,
AKOMODIMIN DHE ORIENTIMIN E MASMEDIEVE PRANË KUVENDIT TË
SHQIPERISË**

Mbështetur në Rregulloren e Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, neni 105, pika 4, me propozim të Kryetarit të Kuvendit, Byroja e Kuvendit në mbledhjen e saj të datës 06.07.2021,

V E N D O S I:

1. Miratimin e disa ndryshimeve në "Rregulloren për akreditimin, akomodimin dhe orientimin e masmedieve pranë Kuvendit të Shqipërisë"(miratuar me vendimin e Byrosë nr.82 datë 02.06.2021) sipas tekstit bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për zbatimin e këtij vendimi.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI

Gramoz RUÇI



“PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË RREGULLOREN PËR AKREDITIMIN, AKOMODIMIN DHE ORIENTIMIN E MASMEDIEVE PRANË KUVENDIT TË SHQIPËRISË”

Në Rregulloren për akreditimin, akomodimin dhe orientimin e masmedieve pranë Kuvendit të Shqipërisë, bëhen shtesat dhe ndryshimet si më poshtë:

1. Neni 12, pika 1 ndryshohet dhe bëhet:

“Te Kryesia e Kuvendit në News Room/ Salla e Gazetarëve, që ndodhet në katin e parë të godinës si dhe në ambjentin e caktuar për ta që ndodhet ne oborrin brenda territorit të Kryesisë së Kuvendit”.

2. Neni 16 ndryshohet dhe bëhet :

“Përfaqësues nga Zyra e Shtypit pranë Kuvendit, shoqëron persona e akredituar gjatë qëndrimit të tyre ne Kuvend, kur është e nevojshme dhe sipas përcaktimeve të kësaj Rregullore.

3. Te Neni 17, pika 2, pas gërmës b), te shtohet nje pikë:

“c) ne ambjentet e sallave te komisioneve përgjatë zhvillimit te mbledhjeve te komisioneve parlamentare dhe mund te jene te paisur edhe me aparatet e tyre celular.

4. Te Neni 18, pas pikës 1, të shtohet një pikë si më poshtë:

Pika 2 “Kuvendi siguron për mediet, marrjen e planeve me kamerat e tyre, në fillimin e mbledhjes së komisioneve parlamentare, për një periudhe kohore deri në 5 min, nga hapja e mbledhjes. Pas marrjes së planeve , operatorët shoqërohen nga punonjësit e zyrës së Shtypit për në ambjentet e përcaktuara për ta në Kryesinë e Kuvendit”.

5. Neni 29, pika 1, ndryshohet dhe bëhet :

“Organizimi i intervistave zhvillohet, pasi vihet ne dijeni Zyra e Shtypit në Kuvend, nga personat e akredituar”.

6. Neni 29, pika 2 hiqet fare.

Miratuar me vendimin e Byrosë nr.86, date 06.07.2021.

